



DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 05-600

17.08.2020

Podujevë

Bazuar në Vendimin për Kushtet, kriteret dhe afatet e regjistrimit të nxënësve në klasën e 10-të, për vitin shkollor 2020-2021(MASH), nr. 01B-70, dt. 07/08/2020, Drejtoria e Arsimit në Podujevë plotëson:

KONKURSIN

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) TË GJIMNAZEVE DHE TË SHKOLLAVE PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2020/2021, NR. 05-599, DT. 14.08.2020

❖ Kriteret e përgjithshme për llogaritjen e pikëve

Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl.6-9) mund t'i fitojë maksimalisht 60 pikë. Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është: (mes. Kl. 6+mes. Kl. 7 + mes. Kl. 8 + mes. Kl. 9) x 3 = 60 pikë max.

Nxënësi nga suksesi në lëndët prioritare, maksimalisht mund t'i fitojnë 40 pikë, shuma e mesatares së 4 lëndëve shumëzohet me 2 (mes.lënda I+mes.lënda II+mes.lënda 3+mes.lënda 4) x 2 = 40 pikë max.

Në rast se nuk mund të bëhet pranimi ngase kandidatët kanë pikë të barabarta do të merren parasysh edhe këto kritere shtesë.

Suksesi në klasat 1-5 (mblidhet nota mesatare e 5 viteve dhe pjesëtohet me 5 pikë).

- Pjesëmarrja në gara ndërkombëtare 5 pikë;
- Vendi i parë në gara shtetërore të diturisë 5 pikë;
- Vendi i dytë në gara shtetërore të diturisë 4 pikë;
- Vendi i tretë në gara shtetërore të diturisë 3 pikë;
- Vendi i parë në gara komunale të diturisë 3 pikë;
- Vendi i dytë në gara komunale të diturisë 2 pikë;
- Vendi i tretë në gara komunale të diturisë 1 pikë;

Nëse shkolla edhe me këto kritere shtesë nuk mund të bëjë përzgjedhjen e kandidatëve me pikë të barabarta, atëherë shkolla për këta kandidat organizon vlerësim apo testim.

Drejtori
Agim Blakcori

